

Sergio Barile

është profesor i menaxhimit pranë Universitetit “La Sapienza” të Romës. I specializuar gjithashtu edhe në kibernetikë dhe psikologji, Prof. Barile është një nga pionerët e aplikimit të teorisë së sistemeve në fushën e menaxhimit.

Xhimi Hysa

është profesor i menaxhimit dhe inovacionit pranë Universitetit POLIS dhe Universitetit Katolik të Milanos. Ai është një nga pionerët e lëvizjes së biznesit social dhe kapitalizmit social në Evropën Lindore.

Sergio Barile

Xhimi Hysa

Sergio Barile

KAPITALIZMI I PJESËMARRJES

Xhimi Hysa

KAPITALIZMI I PJESËMARRJES

Drejt të ardhurave të rinjohjes për një rishpërndarje të drejtë të pasurisë

Tashmë, pjesa më e madhe e botës (asaj materiale, siç e kemi njohur jeton njëkohësisht edhe në një botë tjetër paralele, të mundësuar nga inteligjenca artificiale, realiteti virtual, rrjetet sociale etj. Kjo “botë e re”, kapitalizon pjesëmarrjen e shumicës në favor të pakicës duke e përjashtuar shumicën nga zinxhiri i vlerës. Prandaj, pikëpyetja e madhe që ngrihet është:

-A duhet që bota virtuale -ajo e internetit, e tej pasuruar -t'i rinjohë një pjesë të pasurisë botës reale (asaj fizike, materiale)?

ISBN 9789928347176



9 789928 347176

Çmimi 1000 lekë

Sergio Barile

Xhimi Hysa

KAPITALIZMI I PJESËMARRJES

*Drejt të ardhurave të rinjohjes për një
rishpërndarje të drejtë të pasurisë*



Seritë e Botimeve Shkencore të Universitetit POLIS
Business Complexity and Meta-World Economics
Editorët: Xhimi Hysa, Laura Riolli, Mustafa Üç

***Kapitalizmi i Pjesëmarrjes: drejt të ardhurave
të rinjohjes për një rishpërndarje të drejtë të pasurisë***

Autorët: Sergio Barile, Xhimi Hysa
Reçensentët: Prof. Dr. Andri Koxhaj
Prof. Dr. Laura Riolli
Prof. Asoc. Dr. Mario Calabrese

Shtypur nga: Kristalina – KH
Botuar nga: POLIS University Press
©2024 – Universiteti POLIS_ POLIS University Press

ISBN: 978-99-2834-717-6
e-ISBN: 978-99-2834-716-9
DOI: 10.37199/bse40002601



Përmbatja

Parathënie

Hyrje	17
Përshkrimi i modelit të përfaqësimit	27
Strukturat paradigmatiche të përshkuara mbi dimensionet psiko-sociale, politiko-institucionale dhe shkencore kulturore të shoqërive perëndimore	43
Paradigma e kapitalizmit pronësor.....	49
Paradigma e kapitalizmit posedues (ose financiar)	55
Paradigma e kapitalizmit të pjesëmarrjes (ose njohurive)	61
Përfundime: çdo klikim vlen!	97
<i>Bibliografia e shqyrtuar</i>	105

“Sa më pak të hani, pini, lexoni,
të shkoni në teatër, në ballo apo taverna,
aq më pak mendoni, dashuroni,
teorizoni, këndon, pikturoni, shkruani, etj.,
aq më shumë kurseni dhe
aq më i madh bëhet kapitali juaj.
Sa më pak të jesh, aq më pak e kupton
jetën dhe aq më shumë ke;
sa më e madhe është jeta juaj e tjetërsuar,
aq më shumë grumbulloni
nga qenia juaj e zbrazët

Karl Marks

“Puna është ndëshkim, kështu që mund
të tolerohet, por kurrë të mos dashurohet!

Teze Karolina

Parathënie

Evolucioni i sipërmarrjes së biznesit ka përcaktuar në shumë aspekte edhe evolucionin e kapitalizmit, duke përfshirë subjekte të ndryshme brenda sistemit të tij (kapitalistët, sipërmarrësit, menaxherët, punonjësit, etj.)^I. Duke marrë parasysh se kapitalizmi ka qenë dhe mbetet një sistemi i fuqizuar nga “tregu i lirë”, duhet të kuptojmë se çfarë nënkuptohet me fjalën “kapitalizëm”.

Në vitin 1918, kur ekonomisti gjerman Richard Passow kreu një studim mbi literaturën e kapitalizmit, u gjetën afërsisht 111 përkufizime të lidhura me të^{II}. Për shembull, Marksi e trajtonte kapitalizmin në termat e antagonizmit dinamik midis klasës punëtore dhe borgjezisë^{III}. Weber dhe Sombart theksonin organizimin racional të ndërmarrjes dhe organizimin e punës brenda saj (ndryshe nga puna shtëpiake dhe ajo politike) si tiparet kryesore të kapitalizmit modern^{IV}. Schumpeter e quajti kapitalizmin si një formë të një ekonomie të pronës private në të cilën kryhen inovacione me anë të parave të marra hua që zakonisht përfshin krijimin e

.....

I. Hysa, X., & Calabrese, M. (2015). Innovation: a financial asset of the capitalist or an “intellectual property” of the entrepreneur?. *Procedia Economics and Finance*, 26, 688-694.

II. Kocka, J., (2010). *Writing the History of Capitalism*. German Historical Institute (GHI), Washington, April 29.

III. Marx, K., Engels, F., (1966). *Opere Scelte*, 2nd ed. Roma: Editori Riuniti.

IV. Weber, M., (1927). *General Economic History*, pp. 275-297. New York: Greenberg Publisher.; Sombart, W., (1935). *Capitalism*. In: Seligman, R. A., Johnson, A. *Encyclopedia of the Social Sciences*, ed. Edwin, vol. 3, New York.

II

kredisë^V. Për ekonomistët dhe brezin e parë të kontabilistëve shqiptarë, kapitalizmi përkufizohej si një formë organizative e prodhimit industrial, ku jeta e njeriut si individ dhe pjesëtar i shoqërisë mbetet e lidhur ngushtë me prodhimin e të mirave materiale për të kënaqur nevoja të natyrave të ndryshme, duke u bërë kështu shkas i riprodhimit shoqëror^{VI}.

Mirëpo, kapitalizmi ka pësuar një evolucion të shpejtë qysh prej fillesave të tij. Në origjinë, ai mishërohej në figurën e artizanit tek i cili shkriheshin personazhet e kredi-dhënësit, sipërmarrësit, punëtorit, prodhuesit dhe distributorit. Asokohe, funksione të rëndësishme të biznesit sikurse është sot ai i marketingut, nuk gjenin aplikime me shumë dritëhije. Gjërat ishin më të thjeshta dhe marrëdhënia mes prodhuesit dhe klientit ishte shumë personale. Në të njëjtën kohë, krijimi i vlerës kalonte përmes një zinxhiri më të dallueshëm, të shkurtër dhe të prekshëm. Me kalimin e kohës, duke u përqasur drejt revolucionit të parë industrial, nga kapitalizmi i artizanit shkojmë drejt kapitalizmit të fabrikës ku fokusi është prodhimi dhe standardizimi i produkteve. Mjafton të kujtojmë serinë e makinave Ford, modeli “T”. Gjatë “Fordizmit” filluan të skaliteshin rolet organizative dhe nisi të lindë klasa e menaxherëve duke nxitur ndarjen mes pronësisë dhe menaxhimit^{VII}. Kjo është edhe faza ku punishtet e vogla fillojnë transformimin industrial nën vizionin

.....
V. Schumpeter, J., (1939). *Business Cycles: A Theoretical, Historical and Statistical Analysis of the Capitalist Process*. New York: McGraw-Hill.

VI. Çela, Xh., Kriqi, L., (1962). *Kurs i Kontabilitetit: Bazat e teorisë dhe të teknikës së kontabilitetit sipas partisë dyfishe*. Tiranë: FE-UT.

VII. Fama, E. F., & Jensen, M. C. (1983). Separation of Ownership and Control. *The Journal of Law and Economics*, 26(2), 301-325.

menaxherial duke i hapur dyert kapitalizmit industrial. Konsideruar rëndësinë e kapitalizmit industrial, Di Bernardo dhe Rullani^{VIII} e përkufizojnë atë si një makro-evolucion që përbëhet nga dy forca kryesore:

- shfrytëzimi i shkencës si forcë prodhuese, pra si forcë që prodhon risi;
- konkurrueshmëria si mjet përzgjedhjeje dhe evolimi i strukturave ekonomike, politike dhe kulturore.

Në të vërtetë, kapitalizmi u bë struktura ekonomike mbizotëruese vetëm gjatë industrializimit, që është edhe faza karakterizuese e prodhimit industrial nga sistemi-ndërmarrje. Kapitalizmi nën optikën industriale është edhe një lloj “ngushëllimi” për krizën e transferuar mbi ekonominë reale të mallrave dhe shërbimeve nga ekonomia simbolike e parasë dhe kredisë, rezultat i industrisë financiare dhe “lojërave” në bursë (kujtojmë, p.sh., skandalet e korporatave Enron, Arthur Andersen, Parmalat, Lehman Brothers, etj.). Sipas ekonomistit të mirënjohur italian Federico Caffè^{IX}, «*mbi-struktura financiare me tiparet që paraqet në kapitalizmin e vendeve të zhvilluara, nuk favorizon virtytin e konkurrencës, por një lojë të paskrupullt të stilit grabitqar, duke vepruar sistematikisht në dëm të shumë kategorive të kursimtarëve të pambrojtur. Në thelb, ka një mospërputhje të qartë ndërmjet ndikimeve të çdo lloji që*

VIII. Caffè, F., (1971). Economia di mercato e socializzazione delle sovrastrutture finanziarie. *Giornale degli Economisti*.

IX. Di Bernardo, B., Rullani, E., 1990. *Il management e le macchine*. Bologna: Il Mulino.

kufizojnë veprimtarinë reale prodhuese të sektorëve bujqësorë dhe industrial në favor të ndërmjetësuesve të tregjeve të bursës dhe licencës aktuale që legjitimon veprimtarinë e tregjeve financiare për shpronësimin e kursimeve të njerëzve të tjerë». Ndërkohë që kapitalizmi ka pasur një zhvendosje nga sfera materiale (p.sh., pronë) te ajo simbolike (p.sh., financa e tregjeve / bursa), tashmë, në këtë fazë, jetojmë një kapitalizëm që shkon përtej simbolikes dhe i nënshtrohet rregullave të centrifugës teknologjike dhe globalizimit virtual. Tashmë, pjesa më e madhe e botës (asaj materiale, siç e kemi njohur) jeton njëkohësisht edhe në një botë tjetër paralele të mundësuar nga inteligjenca artificiale, realiteti virtual, rrjetet sociale, etj. Kjo ndodh sepse, në fakt, siç thoshte edhe Peter Drucker, globalizimi nuk është një dukuri ekonomike, por thelbësisht psikologjike. Sot shikojmë rininë (por jo vetëm) në vende të ndryshme të botës të mendojë njësoj, të ushqehet njësoj (për fat të keq, jo në mënyrë të shëndetshme), të vishet njësoj, të luajë njësoj (p.sh., video-lojërat online) etj. Këta njerëz marrin pjesë dhe prodhojnë vlerë në një botë që i largohet gjithmonë e më shumë asaj reale. Kjo “botë e re”, kapitalizon pjesëmarrjen e shumicës në favor të pakicës duke e përjashtuar shumicën nga zinxhiri i vlerës. Prandaj, pikëpyetja e madhe që ngrihet është: a duhet që bota virtuale – ajo e internetit, e tej pasuruar – t’i rinjohë një pjesë të pasurisë botës reale (asaj fizike, materiale)?

Sergio Barile

Xhimi Hysa